

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E FINANCËVE - MINISTARSTVO ZA FINANCJE - MINISTRY OF FINANCE
 KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR
 KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL

Nr./Dr./No. 358/2016 Nr.faq./Br.str./No.pg. _____
 Data/Datum/Date 12.10.2016

PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
 Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Njësia Org. _____ Nr. Prot. _____
 Org. Jedin. 3a Nr. Prot. 09-06-3101
 Org. Unit _____ Prot. No. _____

Nr. / Faqeve _____ Data _____
 Broj stranica _____ Datum _____
 No. pages: _____ Date: 11.10.16

Dalje _____ PRISHTINE / A

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Financave / Ministri Financije / Ministry of Finance



Administrata Tatimore e Kosovës
 (ATK)



Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar
 (KKRF)

**MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT
 NDËRMJET
 ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS
 DHE
 KËSHILLIT KOSOVAR PËR RAPORTIM FINANCIAR**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin në vijim: Marrëveshja) është lidhur ndërmjet palëve nënshkruese duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/L-223, dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.

**Neni 1
 Palët në Marrëveshje**

1. Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (në tekstin në vijim: KKRF) si organ i pavarur profesional, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, përgjegjës për hartimin dhe aprovimin e Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe direktivat relevante të BE-së, e përfaqësuar nga Gem Maloku, Kryetar i KKRF, dhe
2. Administrata Tatimore e Kosovës (në tekstin në vijim: ATK), si Autoritet Ekzekutiv me autonomi të plotë operationale në kuadër të Ministrisë së Financave, e cila është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve tatimore dhe mbledhjen e tatimeve sipas Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, e përfaqësuar nga Sakip Imeri, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës.

Neni 2 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është që përmes bashkëpunimit ndërinstitucional të rritet efikasiteti, saktësia, transparencja dhe disiplina e raportimit financiar nga ana e ndërmarrjeve biznesore, të cilat sipas kërkesave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, janë të obliguara që të përgatisin pasqyra financiare dhe të auditojnë pasqyrat financiare.
2. Me këtë Marrëveshje mund të arrihet në mënyrë më efektive përfundimi i ciklit të raportimit financiar, i cili cikël duhet të përfundojë në përbushjen e obligimeve tatimore nga bizneset të cilat operojnë në Kosovë, kontribut ky i drejtpërdrejt në rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare dhe inkasimit më efikas të obligimeve tatimore.

Neni 3 Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj Marrëveshje ndërlidhet me bashkëpunimin ndërmjet këtyre dy institucioneve në funksion të përbushjes së nenit 2 të këtij dokumenti.

Neni 4 Zotimi i palëve në Marrëveshje

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, palët nënshkruese janë dakorduar që të zhvillojnë program bashkëpunimi në atë drejtim që:
 - 1.1. ATK, bazuar në interesin e ndërsjellë pajtohet që në kuadër të metodologjisë së punës së inspektimit tatimor, të përfshihet edhe inspektimi lidhur me shkallën e përbushjes së kërkesave që dalin nga Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim:
 - 1.1.1. lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe auditimit e pasqyrave për ndërmarrjet e klasifikuara si ndërmarrje të mëdha;
 - 1.1.2. lidhur me inspektimin e përpilimit të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; dhe
 - 1.1.3. lidhur me kërkesën për auditimin e pasqyrave financiare për ndërmarrjet të cilat sipas ligjit klasifikohen si të mesme.
 - 1.2. Po ashtu, ATK pajtohet që t'i raportoj KRRF listën e tatimpaguesve të cilët sa i përket raportimit financiar dhe auditimit të pasqyrave financiare nuk i respektojnë kërkesat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

- 1.3. ATK, zotohet se Sistemi i Deklarimit Elektronik (EDI) do të mundëson pranimin e raportimit elektronik të pasqyrave financiare (PF) dhe opinionit të auditimit nga ana e tatimpaguesve. Secilit tatimpagues gjatë dorëzimit elektronik të deklaratës vjetore tatimore, në sistemin elektronik, do t'i mundësohet edhe dorëzimi i pasqyrave financiare dhe opinionit të auditimit.
 - 1.4. ATK, me këtë Marrëveshje zotohet se do t'i mundësoj KKRF-së qasje në informatat e pranuar dhe të përpunuara nga sistemi elektronik i raportimit për të analizuar të gjitha pasqyrat financiare të dorëzuara nga tatimpaguesit dhe përgatitjen e raportit statistikor vjetor.
 - 1.5. ATK, do të jetë e përkushtuar që të mbaj edukim të vazhdueshëm të tatimpaguesve së bashku me KKRF.
2. KKRF, bazuar në interesin e ndërsjellë pajtohet që:
- 2.1. Të ofroj asistencë teknike/profesionale në përgatitjen e sistemit për deklarim elektronik të pasqyrave financiare dhe opinionit të auditorit.
 - 2.2. KKRF, zotohet që të mbaj seminar/edukim të vazhdueshëm për inspektorët tatimor rreth kërkesave të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe kërkesave sipas Udhëzimeve Administrative përkatëse.
 - 2.3. KKRF, pajtohet që t'i ofroj ATK-së qasje të pakufizuar në çdo kohë në të gjitha informatat relevante për çështjet tatimore të cilat ajo i ka në zotërim.
 - 2.4. KKRF, pajtohet që të kontribuoj në mënyrë të vazhdueshme në grupet punuese të ATK-së gjatë draftimit të Udhëzimeve Administrative apo Shpjegimeve Publike, të cilat ndërlidhen me temat si: Pasqyrat Financiare, Auditimi, Aplikimi i Standardeve të Kontabilitetit dhe të ngjashme.
 - 2.5. Po ashtu, KKRF pajtohet që të mbaj edukim të vazhdueshëm të ndërmarrjeve biznesore së bashku me ATK.

Neni 5

Obligimet e dyanshme të palëve kontraktuese

1. Palët obligohen që së bashku të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet për implementimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe finalizimin e kësaj Marrëveshje.
2. Palët do të caktojnë nga një person kontaktues, i cili do të përkujdeset drejtpërdrejt për mbikëqyrjen në zbatimin e kësaj Marrëveshje.

Neni 6
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi fillon së zbatuari me rastin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe vazhdon për një kohë të pacaktuar.
2. Palët në rast zgjidhje të njëanshme të kësaj Marrëveshje, janë të obliguara që paraprakisht në një afat prej tridhjetë (30) ditësh të njoftojnë me shkrim njëra tjetrën se nuk janë të interesuara të vazhdojnë bashkëpunimin.
3. Çdo çështje tjetër e pa trajtuar në këtë Marrëveshje, do të zgjidhet në pajtueshmëri të palëve, në përputhje me Legjislacionin Tatimor dhe Legjislacionin mbi Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin.

Neni 7
Ndryshimi, nënshkrimi, hyrja në fuqi dhe publikimi

1. Kjo Marrëveshje iu është referuar palëve nënshkruese dhe nuk mund të transferohet të palët e tjera.
2. Plotësimi dhe ndryshimi i kësaj Marrëveshje mund të bëhet vetëm me pajtimin e shprehur me shkrim nga të dy palët.
3. Kjo Marrëveshje është e nënshkruar nga personat e autorizuar dhe është e hartuar në katër kopje (4) të njëjta, nga dy (2) kopje për secilën nga palët nënshkruese.
4. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të palëve.



Datë: 11/10/2016

Këshilli Kosovar për Raportim Financiar



Z. Gem Maloku
Kryetar

Datë: 11/10/2016

Prishtinë